



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË BUJQËSISË,  
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 4607 prot.

Tiranë, më 16.06.2021

Lënda: Dërgohet udhëzuesi “Për përdorimin e Mjeteve Mbrojtëse Personale (MMP)”

**AUTORITETIT KOMBËTAR TË VETERINARISË DHE  
MBROJTJES SË BIMËVE**

**Tiranë**

Bashkëlidhur po ju përcjellim udhëzuesin “Për përdorimin e Mjeteve Mbrojtëse Personale (MMP)”, që do të përdoren për mbrojtjen nga kontaminimi dhe infektimi nga agjentët patogjenë, për zbatim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Enea Hoti**

# Udhëzues për Përdorimin e Mjeteve Mbrojtëse Personale (MMP)

---

**(PËR MJEKËT VETERINERË)**

1. Përdorimi i MMP-ve .....	3
2. Llojet e MMP .....	3
2.1. Dorezat .....	4
2.2. Përparësja/veshja mbrojtëse .....	5
2.3. Mbrojtja e Këmbëve .....	6
2.4. Mbrojtja e frymëmarrjes .....	7
2.5. Mbrojtja e Fytyrës.....	7
2.5.1.....	7
2.5.2. Mbrojtësja e Fytyrës.....	8
3. Përdorimi në mënyrën e duhur i MMP-ve .....	8
3.1. Veshja e MMP .....	9
3.1.1. Përparësja/veshja mbrojtëse për rrobat .....	9
3.1.3. Syzet dhe maska mbrojtëse e fytyrës .....	10
3.2. Përdorimi me efikasitet i MMP-ve.....	10
3.2. Heqja e MMP-ve.....	11
3.2.1. Si ta hiqni në mënyrë të sigurtë një MMP?.....	11
3.2.2. Ku mund të hiqen MMP-të?.....	11
3.2.3. Rradha për Heqjen e MMP-ve .....	12
3.2.4. Heqja e MMP-ve shumëpërdorimshe.....	14
3.2.5. Pastrimi dhe denzinfektimi i çizmeve .....	14

## 1. Përdorimi i MMP-ve

Mjete Mbrojtëse Personale (MMP) quhen të gjitha ato Veshje ose Mjete të specializuara që vishen nga një Mjek veteriner ose punonjës ndihmës për mbrojtjen nga kontaminimi dhe infektimi nga agjentët patogjenë.

Përdorimi i Mjeteve Mbrojtëse Personale në aktivitetin e mjekut veterinar është gjithashtu shumë i rëndësishëm për parandalimit e përhapjes së sëmundjeve infektive ose zoonotike nga personat që punojnë në zona/mjedise apo kafshë të infektuara nga sëmundje infektive.

Bazuar në aktivitetin dhe nevojën e sigurisë së personelit që do të punojë në mjedisin/zonën e kontaminuar është e nevojshme përcaktimi dhe përdorimi i MMP-ve të përshtatshme.

## 2. Llojet e MMP

Llojet e MMP që duhet të përdorë një mjek veteriner janë:

1. **Dorezat** – për mbrojtjen e duarve.
2. **Pëparëse/veshje** - për mbrojtjen e lëkurës dhe/ose veshjeve
3. **Maska për frymëmarrjen** - për mbrojtjen e gojës dhe hundës
4. **Syzet** - për mbrojtjen e syve
5. **Mburoja e fytyrës** - për mbrojtjen e fytyrës, gojës, hundës dhe syve
6. **Çizme gome/veshje mbrojtëse për këpucët**



Të gjitha MMP-të e listuara më sipër parandalojnë kontaktin me agjentin infektiv, lëngjet, ajrin ose ambientin që mund të përmbajë agjentin infektiv, duke krijuar një pengesë midis mjekut veteriner ose punonjësit me materialet potencialisht të infektuara.

Kur zgjidhni një MMP, duhet të keni parasysh tre gjëra kryesore:

- ✓ E para është lloji i ekspozimit që parashikohet. Kjo përcaktohet nga lloji i ekspozimit të parashikuar, të tilla si prekja, spërkatjet ose lëngjet që mund të depërtojnë në veshje. Përzgjedhja e MMP, në veçanti kombinimi i MMP, përcaktohet gjithashtu nga kategoria e masave të izolimit që kërkohen.
- ✓ E dyta, dhe shumë e lidhur me të parën, është qëndrueshmëria dhe përshtatshmëria e MMP për detyrën që do të kryhet. Kjo do të ndikojë, për shembull, nëse përzgjidhet një veshje mbrojtëse ose pëparëse si MMP, ajo duhet të jetë rezistente ndaj përshkimit të lëngjeve ose stërpiklave.


- ✓ E treta është e madhësia. MMP duhet t'i përshtatet individualisht përdoruesit dhe duhet të sigurohen që të gjitha MMP në madhësi të përshtatshme për përdoruesin që duhet të mbrohet gjatë punës. Nëse një MMP është shumë i vogël apo i madh ai vështirëson punën ose mund të dëmtohet prishet gjatë punës dhe të rrezikojë kontaminimin/ infektimin e personit?

## 2.1. Dorezat

Kur nevojiten doreza për përdorim, duhet të keni parasysh klasifikimin e tyre sipas:

- Materialit - vinile, lateksi, nitrile, të tjera
- Sterile ose jo-sterile
- Një ose dy palë
- Një përdorimshe ose shumëpërdorimshe.

Dorezat janë lloji më i zakonshëm i MMP të nevojshme për tu përdorur në mjediset që kanë rrezikshmëri kontaminimi ose infektimi. Kur përzgjidhni dorezat janë disa gjëra që duhet të merren parasysh për përzgjedhjen e dorezave të duhura për qëllimin që ju i kërkoni.



Shumica e aktiviteteve gjatë kujdesit ndaj kafshëve kërkojnë përdorimin e një pale të vetme dorezash josterile prej lateks, nitrile, ose vinile. Megjithatë, për shkak të shqetësimeve alergjike, janë eliminuar ose kufizuar produktet e lateksit, duke përfshirë edhe dorezat, dhe tani përdoren doreza të bëra nga nitrile ose materiale të tjera. Doreza vinyl janë gjithashtu shpesh në dispozicion dhe punohet mirë me to nëse ka kontakt të kufizuar me agjentët infektiv. Megjithatë, disa doreza nuk përshtaten mirë në duar, veçanërisht në kyçin e dorës, dhe për këtë arsye nuk duhet të përdoren nëse ka gjasa të ketë kontakt të gjerë me agjentin infektiv.

Dorezat duhet t'i përshtaten plotësisht duarve të përdoruesit - ato nuk duhet të jenë shumë të lirshme ose shumë të shtrënguara. Ata gjithashtu nuk duhet të hiqen ose dëmtohen lehtë. Dorezat ndonjëherë mund të mbahen për disa orë dhe duhet të mbahen deri në përfundimin e të gjithë punës që do të kryhet.

Gjatë disa procedurave kur kërkohet kujdes i veçantë (p.sh. përpunimi i kadavrave të kafshëve të ngordhura nga plasja) ku mund të përdoren dy palë doreza.

Dorezat ju mbrojnë nga kontakti me materialet infektive. Megjithatë, kur kontaminohen, dorezat mund të kthehen nje mjet për përhapjen e materialeve infektive tek vetja, punonjësit e tjerë ose në mjedis. Prandaj, mënyra se si i përdorni dorezat mund të ndikojë në rrezikun e transmetimit të sëmundjes në njerëz, kafshë ose në mjedis.

## Rradha e punës

Puna duhet të fillojë nga zonat e "pastra" drejt atyre të "pista". Ky është një parim bazë për kontrollin e infeksionit. Në këtë rast, i referohemi prekjes së vendeve ose sipërfaqeve të pastra në fillim përpara se të preken zonat e ndotura ose të ndotura rëndë.

Kufizoni mundësitë për "kontaminim me prekje" - mbroni veten, të tjerët, kafshët dhe mjedisin. Mos e prekni fytyrën tuaj me doreza të ndotura. Mos prekni me doreza të ndotura mjete dhe sipërfaqe të tjera përveçse kur është e nevojshme.

Përdorini dhe mos i hiqni dorezat gjatë punës tuaj. Kur dikuh rregullon syzet, fshin hundën ose prek fytyrën e tij me doreza që kanë qenë në kontakt me një infeksion, ky është një shembull i "kontaminimit me prekje" që potencialisht mund të ekspozohet ndaj agjentëve infektivë. Kufizoni mundësitë për "kontaminim me prekje" - mbroni veten, të tjerët dhe mjedisin.

Ndërroni gjithmonë dorezat pas përdorimit për kontrollin e një kafshe të dyshuar, nëse kafsha është e sëmurë ju rrezikoni të përhapni sëmundjen në kafshë të tjera ose në njerëz.

Ndryshojini dorezat sipas nevojës. Nëse dorezat shqyhen, grisen ose kur janë shumë të ndotura dhe nuk e keni kryer të gjithë punën, atëherë ndryshoni dorezat para rifillimit të punës.

Hidhini ato në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave më të afërt.

Asnjëherë mos i lani ose mos i ripërdorni dorezat një përdorimshe, Larja jo domosdoshmërisht i bën ato të sigurta për ripërdorim; mund të mos jenë eliminuar të gjitha mikroorganizmat ose larja mund ti dëmtojë ato dhe bën që dorezat të mos jenë më të sigurta për tu ripërdorur

## 2.2. Përparësja/veshja mbrojtëse

Gjatë përzgjedhjes së një Përparëseje apo veshjeje mbrojtëse si MMP duhet të keni parasysh tre faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e duhur.

Faktori i parë është qëllimi i përdorimit. Përparësja/veshja mbrojtëse është në përgjithësi MMP më e preferuar për mbrojtjen/izolimimin e veshjeve nga ndotja/kontaminimi. Në varësi të punës dhe rrezikut nga kontaminimi mund të përzgjidhet një përparëse ose një veshje mbrojtëse për të gjithë trupin, me mëngë të gjata dhe kapuç. Veshja mbrojtëse duhet të përshtatet lehtë mbi trup dhe të jetë e papërshkueshme nga lëngjet e kontaminuara.

Faktori i dytë janë vetitë materiale të përparëses/veshjes mbrojtëse. Në bazë të nevojës, veshja mbrojtëse mund të përzgjidhet në shkallë të ndryshme rezistence ndaj përshkueshmërisë së lëngjeve, i cili është një faktor tjetër i



rëndësishëm që duhet të merret parasysh në përzgjedhjen e tyre. Nëse ka mundësi që lëngjet të depërtojnë, duhet të përdoret një veshje rezistente ndaj lëngjeve.

Faktori i fundit ka të bëjë me rrezikun për përdoruesin nëse mund të ripërdorë një përparëse/veshje mbrojtëse shumëpërdorimshe. Nëse ato janë prej materiali polipropilen njëpërdorimshe, pas përdorimit ato duhet të hidhen në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave. Kur rrezikshmëria e agjentit infektiv është e ulët, mund të përdoren përparëse/veshje mbrojtëse prej gome shumëpërdorimshe të cilat mund të pastrohen, denzinfektohen dhe ripërdoren.

### 2.3. Mbrojtja e Këmbëve

Mbrojtja e këmbëve mund të bëhet duke përdorur si MMP


- Veshje mbrojtëse për këpucët - njëpërdorimshe
- Çizme gome - shumëpërdorimshe

Gjatë përzgjedhjes së çizmeve të gomës apo veshjeve mbrojtëse për këpucët si MMP duhet të keni parasysh tre faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e duhur.

Faktori i parë është qëllimi i përdorimit. Çizmet e gomës ose Veshjet mbrojtëse për këpucët janë MMP më e domosdoshme për mbrojtjen/izolimimin nga ndotja/kontaminimi. Në varësi të punës dhe rrezikut nga kontaminimi mund të përzgjidhen Çizmet e gomës ose Veshjet mbrojtëse për këpucët.

Faktori i dytë janë vetitë materiale të Çizmeve të gomës apo Veshjeve mbrojtëse për këpucët. Në bazë të nevojës, ato mund të përzgjidhet në shkallë të ndryshme rezistence ndaj përshkueshmërisë së lëngjeve, i cili është një faktor tjetër i rëndësishëm që duhet të merret parasysh në përzgjedhjen e tyre. Nëse ka mundësi që lëngjet të depërtojnë, duhet të përdoret Mbrojtëse për këmbët të padëmtuara dhe të papërshkueshme nga lëngjet e kontaminuara. Gjithashtu nëse terreni ku do të punohet është i ashpër dhe rrezikohet që mbrojtësja e këmbëve të dëmtohet dhe kontaminimi të depërtojë atëherë ato duhet të jenë rezistente ndaj demtimeve mekanike. Nëse si MMP do të përdoren çizmet e gomës atëherë kujdes duhet të tregohet në përzgjedhjen e madhësisë së duhur.

Faktori i fundit ka të bëjë me rrezikun për përdoruesin nëse mund të ripërdorë Çizmet e gomës si MMP shumëpërdorimshe. Nëse / Veshjet mbrojtëse për këpucët ato janë prej materiali polipropilen njëpërdorimshe, pas përdorimit ato duhet të hidhen në enën/qesen e



përshtatshme të mbeturinave. Kur rrezikshmëria e agjentit infektiv është e ulët, mund të përdoren Çizmet e gomës shumëpërdorimshe të cilat mund të pastrohen, denzinfektohen dhe ripërdoren.

### Rradha e punës

Çizmet e gomës/ Veshjet mbrojtëse për këpucët vishen në zonën e pastër dhe mbahen gjatë gjithë kohës që do të qëndroni në zonën e kontaminuar. Përzgjedhja e tyre bëhet bazuar në nevojën dhe vetitë që ato kanë.

Puna duhet të fillojë nga zonat e "pastra" drejt atyre të "pista". Ky është një parim bazë për kontrollin e infeksionit. Në këtë rast, i referohemi fillimit të punës në vende ose sipërfaqeve të pastra në fillim përpara se të hyhet zonat e ndotura ose të ndotura rëndë.

## 2.4. Mbrojtja e frymëmarrjes

Llojet e MMP për mbrojtjen e frumëmarrjes janë:

- Maskë e thjeshtë
- Maskë që mbulon gjysmën ose plotësisht fytyrën
- Maskë me filtër pastrimi të ajrit (PAPR)

Maskat mbrojtëse për frymëmarrjen më të përdorura janë ato me filtër mbrojtës N 95, N 99 ose N 100. Filtri është i aftë për të ndaluar grimcat që kanë një diametër më pak se 5 mikronë.

**Maska** – Duhet të mbulojë plotësisht hundët dhe gojën dhe të parandalojë depërtimin e lëngjeve/ajrit të kontaminuar në rrugët e frymëmarrjes. Ajo duhet të përshtatet në pjesën e sipërme me hundën për tu puthitur mbas fytyrës dhe të mos lejojë depërtimin e ajrit. Për këtë arsye, preferohen maska që kanë në pjesën e sipërme një përshtatës fleksibël me hundën dhe që kanë mbajtëse llastiku që vendosen rreth kokës.



## 2.5. Mbrojtja e Fytyrës

Një kombinim i disa llojeve të MMP mund të gjëndet për të mbrojtur të gjitha pjesët e fytyrës nga kontakti me materiale potencialisht infektive. Përzgjedhja e MMP për fytyrën përcaktohet nga masat paraprake të mbrojtjes nga kontaminimi që kërkohet për personin që do të punojë ose natyra e kontaktit me materiale potencialisht infektive.

### 2.5.1. Syzet




Syzet mbrojtëse shërbejnë për të mbrojtur sytë dhe duhet të përshtaten me sytë, mbi dhe përreth syve.

Syzet personale nuk mund të zëvendësojnë syzet mbrojtëse.

Funksioni anti-mjegull përmirëson qartësinë e të shikuarit.

Syzet sigurojnë një barrierë mbrojtëse për sytë; lentet dhe syzet optike personale nuk sigurojnë mbrojtje optimale të syve dhe nuk duhet të përdoren si zëvendësim për syzet mbrojtëse.



Syzet mbrojtëse duhet të përshtaten me lehtësi mbi dhe përreth syve ose syzeve optike personale.

Syzet mbrojtëse me funksionin anti-mjegull ndihmojnë në ruajtjen e qartësisë së shikimit.

### 2.5.2. Mbrojtësja e Fytyrës

• Mbrojtësja e fytyrës - mbron fytyrën, hundën, gojën dhe sytë

- Duhet të mbulojë ballin, të shtrihet nën mjekër dhe të përfundojë rreth dhe anës fytyrës

Kur është e nevojshme mbrojtja jo vetëm e gojës, hundës dhe e syve por edhe mbrojtja e lëkurës, për shembull, kur pika gjaku ose sekrecionesh mund të bien në fytyrë, mburoja e fytyrës mund të zëvendësojë maskën për frymëmarrjen dhe syzet.



Maska mbrojtëse për frymëmarrjen


Shërben për mbrojtjen nga thithja (inhalimi) i aerosoleve infektive (p.sh., Mycobacterium tuberculosis).

## 3. Përdorimi në mënyrën e duhur i MMP-ve

Si ti vishni, Përdorni dhe Hiqni MMP kini parasysh katër pikat kryesore për t'u kujtuar për përdorimin e MMP, sa më poshtë:

Kontrolloni Mjetet Mbrojtëse Personale para përdorimit, para kontaktit me kafshët, para se të hyni në ambientin e kontaminuar. Ato vishen para se të keni ndonjë kontakt me kafshën ose ambientin e kontaminuar, përgjithësisht para se të hyni në stallë.

Punoni me kujdes - mos përhapni ndotjen. Pasi ti keni vendosur MMP ato mund të ndoten, ndaj bëni kujdes për të mos përhapur kontaminimin.



Hiqni dhe hidhni me kujdes MMP, në hyrje ose menjëherë jashtë ambientit të kontaminuar; hiqni maskën për mbrojtjen e frymëmarrjes vetëm jashtë stallës, ambienteve ku mbahen kafshët.

Kujdesuni menjëherë për higjienën e duarve. Lajini dhe denzinfektojini ato. Pastaj mund të zhvendoseni në një zonë të pastër.

### 3.1. Veshja e MMP

Gjatë veshjes së MMP duhet të ndiqer rradha si më poshtë:

Vishet përparësja/veshja mbrojtëse për rrobat

Vendoset maska mbrojtëse për frymëmarrjen

Vendosen syzet ose mbrojtësja e fytyrës

vishen çizmet/mbrojtëset për këpucët

Vishen dorezat

#### 3.1.1. Përparësja/veshja mbrojtëse për rrobat

Përparësja/veshja mbrojtëse për rrobat duhet të vishet e para. Maska mbrojtëse për frymëmarrjen duhet të vendoset në vijim dhe duhet rregulluar si duhet; mos harroni të përshtateni pjesën mbi hundë të maskës. Syzet dhe mbrojtësja e fytyrës duhet të vishen më pas. Pasi është plotësuar pothuajse plotësisht veshja e MMP vishen çizmet/mbrojtëset për këpucët. Të fundit vishen dorezat. Mbani në mend, kombinimi i MMP që do të përdoren, dhe rrjedhimisht rradha për ti veshur ato, do të përcaktojë edhe masat paraprake që duhen marrë. Zgjidhni llojin dhe madhësinë e duhur të përparësjes/veshjes mbrojtëse për rrobat.

#### 3.1.2. Maska mbrojtëse për frymëmarrjen

E dyta vendoset Maska mbrojtëse për frymëmarrjen. Vendosja e saj bëhet duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- Vendoseni mbi hundë, gojë dhe mjekër maskën mbrojtëse për frymëmarrjen.
- Vendosni pjesën fleksibile për hundën mbi hundë.
- Sigurojeni në kokë me anë të lidhëseve elastike. Nëse një maskë ka dy lidhëseve elastike, ndani dy lidhëset, mbani maskën në njëren dorë dhe lidhëset në tjetrën. Tërhiqni lidhëset elastike kur mundet duke e përshtatur sipas madhësisë që ju duhet.



- Vendosni dhe mbani maskën mbi hundë, gojë dhe mjekrën tuaj, pastaj vendosini lidhëset elastike duke i kaluar mbi kokën tuaj; një lidhëse në pjesën e sipërme të kokës suaj, tjetra nën veshë në fund të qafës.
- Përshtatni gjatësinë në mënyrë që anët e maskës në të gjithë gjatësinë të jenë të puthitura me fytyrën.

Mbani mend, maskën nuk duhet ta prekni gjatë përdorimit, prandaj merrni masat e nevojshme për tu siguruar se është vendosur në mënyrë të sigurt në kokën tuaj si dhe është përshtatur plotësisht në fytyrën tuaj dhe që nuk ka boshllëqe.


### 3.1.3. Syzet dhe maska mbrojtëse e fytyrës

Për të vendosur syzet dhe maskën mbrojtëse e fytyrës ndiqni hapat e mëposhtme:

Vendosni syzet mbi sytë dhe sigurojini në kokë duke vendosur mbi vesh bishtat e tyre ose lidhësen elastike rreth kokës


Mbështetni maskën mbrojtëse të fytyrës në fytyrës dhe sigurojeni duke vendosur lidhësen elastike rreth kokës.

Rregulloni për ti përshtatur në mënyrë që të qëndrojnë sa më mirë.



### 3.1.4. Dorezat

MMP e fundit për t'u veshur janë dorezat. Sigurohuni që të zgjidhni llojin e dorezave të nevojshme për punën dhe madhësinë që ju përshtatet më mirë në duar. Vishni secilën dorezë në dorën e duhur dhe përshtatni sipas nevojës për lirshmërinë e të lëvizurit. Nëse keni veshur përparëse/veshje mbrojtëse për rrobat, vendosni fundin e mëngëve të tyre nën secilën dorezë. Kjo siguron një mbrojtje të lëkurës tuaj nga kontaminimi.



## 3.2. Përdorimi me efikasitet i MMP-ve

Që përdorimi i MMP-ve të ketë efikasitet, gjatë punës duhet të keni parasysh që të:

- Shmangni prekjen e fytyrës me duart e veshura me doreza.
- Shmangni prekjen ose rregullimin e MMP të tjera.
- Hiqni dorezat e grisura apo copëtuara dhe lani dhe dezinfektoni duart para se të vishni një palë doreza të reja.

- Kufizoni sipërfaqet dhe mjetet e tjera që prekni.

Përveç veshjes së MMP, duhet të përdorni edhe praktika të sigurt të punës. Shmangni ndotjen e vetes duke i mbajtur duart larg nga fytyra juaj dhe duke mos prekur apo përshtatur MMP-të. Gjithashtu, hiqini dorezat tuaja nëse ato grisen apo shpohen dhe lani dhe dezinfektoni duart para se të vishni një palë doreza të reja. Gjithashtu duhet të shmangni përhapjen e kontaminimit duke kufizuar prekjën me dorezat e ndotura/kontaminuara të sipërfaqeve të objekteve dhe mjeteve të panevojshme.

## **3.2. Heqja e MMP-ve**

### **3.2.1. Si ta hiqni në mënyrë të sigurtë një MMP?**

Për të mbrojtur veten, kolegët tuaj dhe ambientin nga ekspozimi ndaj materialeve të kontaminuara. E rëndësishme është edhe mënyra e heqjes së sigurtë MMP. Për ta bërë këtë është e nevojshme të përcaktohen zonat e MMP-ve dhe të njhen përkufizimet "E ndotur" dhe "E pastër".

"E ndotur" ose e kontaminuar – konsiderohet pjesa e jashtme e MMP që kanë qënë apo mund të kenë qënë në kontakt me vendet e trupit trupit të kafshëve, mjetet ose sipërfaqet e mjedisit në të cilat mund të jenë të pranishëm mikroorganizmat patogjenë infektiv.

"E pastër" - konsiderohet pjesa e brëndshme, dhe pjesa e pasme e PPM-ve, si dhe pjesa e pasme e lidhëseve elastike të disa PPM-ve të vendosen në kokë.

Zonat e MMP që nuk kanë qënë në kontakt me kafshën/vendet e kontaminuara me agjentë infektiv.

Për të hequr në mënyrë të sigurtë MMP, së pari duhet të jeni në gjendje të identifikoni se cilat pjesë konsiderohen si "të pastra" dhe cilat si "të kontaminuara". Në përgjithësi, pjesa e jashtme e përparësës/veshjejes mbrojtëse për rrobat, maska mbrojtëse për frymëmarrjen, syzet dhe mburoja e fytyrës konsiderohen si "të kontaminuara". Gjithashtu pjesa e jashtme e dorezave janë "të kontaminuara".

Zonat që konsiderohen "të pastra" janë pjesët që do të preken kur të hiqen MMP. Ato përfshijnë pjesën e brëndshme të dorezave; pjesën e brëndshme të përparësës/veshjejes mbrojtëse për rrobat, llastikët e maskës mbrojtëse për frymëmarrjen, syzeve dhe mburojës së fytyrës.

### **3.2.2. Ku mund të hiqen MMP-të?**

Në hyrje të stallës apo ambieteve ku mbahen kafshët, para se të largoheni ose kur ndodheni në ambjent ose mjedis të të hapur në kufirin që ndan zonën e kontaminuar me zonën e pastër.

Hiqni Maskën mbrojtëse për frymëmarrjen jashtë stallës apo ambieteve ku mbahen kafshët, pasi është mbyllur dera

Sigurohuni që Mjetet për higjenën e duarve të jenë në dispozicion në pikën e nevojshme, p.sh. zhytja ose fërkimi i duarve me alkool

Vendi për heqjen e MMP do të jetë në varësi nga sasia dhe lloji i MMP që janë veshur si dhe kategoria e izolimit që nevojitet gjatë punës që do të kryhet, nëse vishen vetëm dorezat, heqja dhe hedhja e tyre mund të bëhet menjëherë pasi është përfunduar puna e kërkuar ( p.sh. marrja e mostrave). Nëse janë veshur disa ose të gjitha MMP pasi niveli i rrezikut është i lartë, atëherë si vend për heqjen e tyre zgjidhet një vend ku nuk ka rrezik për infektim apo kontaminim, psh në hyrje të stallës apo ambienteve ku mbahen kafshët, ose kur është mjedis i hapur jashtë perimetrit të zonës së kontaminuar.

Larja dhe denzifektimi i duarve duhet të kryhet pas heqjes së MMP-ve.

### 3.2.3. Rradha për Heqjen e MMP-ve

Ashtu si edhe veshja e MMP edhe për heqjen e tyre duhet të ndiqet një rradhë e caktuar. Rradha për heqjen e MMP ka për qëllim të kufizojë mundësitë për vetëkontaminim. Për këtë arsye ndiqet rradha si më poshtë:

- Çizmet/mbrojtëset për këpucët
- Dorezat
- Mburoja e fytyrës ose syzet
- Përparësja/veshja mbrojtëse për rrobat
- Maska mbrojtëse për frymëmarrjen

Çizmet/mbrojtëset për këpucët konsiderohen si pjesa më e ndotur e MMP dhe prandaj ato hiqen të parat. Pas tyre hiqen dorezat të cilat po ashtu mund të kenë një nivel të lartë ndotjeje. Mburoja e fytyrës ose syzet janë hapi i rradhës, sepse ato janë më të vështira për tu hequr dhe mund të pengojnë në heqjen e MMP të tjera. Pas tyre janë Çizmet/mbrojtëset për këpucët të ndjehura nga heqja e përparësjes/veshjes mbrojtëse për rrobat. Në fund hiqet Maska mbrojtëse për frymëmarrjen

#### **Si ti hiqni dorezat?**

Kapni buzën e dorezës në pjesën e jashtme pranë mëngëve

Tërhiqeni nga dora, duke e kthyer dorezën brenda-jashtë me anën e ndotur të saj nga brenda.

Mbajeni të mbledhur në dorën e kundërt.

Rrëshqisni dy gishtat e dorës pa dorezë nën dorezën e dorës tjetër

Hiqeni duke e kapur nga brenda në të njëjtën mënyrë si doreza e parë. doreza kthehet brenda-jashtë duke krijuar një qese për të dyja dorezat


Hidhini ato në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave më të afërt.

### Heqja e syzeve ose mburojës së fytyrës

Hiqni lidhësen elastike të syzeve ose mburojës së fytyrës duke e kaluar mbi kokën tuaj.


Largojeni nga fytyra

Hidheni në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave më të afërt.



### Heqja e përparësës/veshjes mbrojtëse për rrobat njëpërdorimshe.

Zbërtheni zinxhirin e përparësës/veshjes mbrojtëse për rrobat. Futni duart nën veshje në fillim nën kapuçin e kokës pastaj në kraharor dhe shpatulla. Gjatë gjithë veprimeve për heqjen e përparësës/veshjes mbrojtëse për rrobat duhet të shmangët kontakti/prekja me duart të pjesës së jashtme të veshjes mbrojtëse. Mëngët hiqen duke kapur dhe mbajtur me gishtat e dorës tjetër nën iletastikun në fund të mëngës dhe tërheqjen e krahut brënda tyre. Në të njëjtën mënyrë vepron edhe për heqjen nga këmbët duke i kapur nga iletastiku në fund të këmbëve. Në fund të gjithë procesit përparësja/veshja mbrojtëse mbliidhet duke mbetur në dukje pjesa e brendëshme e veshjes. (Vetëm pjesa "e pastër" e veshjes duhet të jetë e dukshme). Hidheni në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave më të afërt.



### **Heqja e maskës mbrojtëse të frymëmarrjes**

Pjesa e përparme e maskës konsiderohet e ndotur dhe nuk duhet të preket.

- Hiqni fillimisht lidhësen elastike të poshtme duke e kaluar mbi kokën tuaj
- Pastaj hiqni lidhësen elastike të sipërme në të njëjtën mënyrë.
- Largoni me ngadalë Maskën nga fytyra pa e fërkuar me lëkurën e fytyrës
- Hidheni në enën/qesen e përshtatshme të mbeturinave më të afërt

### **Higjiena e duarve**


Higjiena e duarve është thelbësore në parandalimin e transmetimit të infeksionit.

- lani dhe dezinfektoni duart menjëherë pas heqjes së MMP.
- Nëse duart ndoten gjatë heqjes së MMP, lani duart para se të vazhdoni të hiqni MMP
- Lani duart me sapun dhe ujë të ngrohtë ose në mungesë fërkoni duart me alkool

Sigurohuni që mjetet për denzinfektimin e duarve të jenë në dispozicion, p.sh. për të zhytur ose fërkuar duart me alkool.

#### **3.2.4. Heqja e MMP-ve shumëpërdorimshe.**

Mbani mend që të gjitha MMP shumëpërdorimshe përpara se të hiqen duhet të pastrohen dhe denzinfektohen. Ashtu si edhe për MMP njëpërdorimshe vendi ku ato duhet të pastrohen dhe denzinfektohen është kufiri ndërmjet zonës së pastër me zonën e kontaminuar (Në hyrje të stallës apo ambienteve ku mbahen kafshët, ose kur ndodheni në ambient ose mjedis të hapur në kufirin që ndan zonën e kontaminuar me zonën e pastër).



#### **3.2.5. Pastrimi dhe denzinfektimi i çizmeve**

Për pastrimin dhe denzinfektimin e çizmeve nevojiten një vasketë/kovë në madhësinë që mund të futen çizmet brënda dhe një furçë për të pastruar mekanikisht papastërtitë.

Vasketa e mbushur paraprakisht me denzinfektant të holluar me ujë në raportin e rekomanduar nga prodhuesi deri në sasinë që mundëson futjen e këmbëve pa u derdhur vendoset në kufirin e zonës së pastër me atë të kontaminuar. Afrohesh pranë vasketës duke futur njërën këmbë brënda. Çizmja fërkohet me furçë derisa të jetë larguar çdo papastërti e mundshme. Këmba nxirret dhe vendoset në krahun tjetër të vasketës ku nuk keni shkelur më parë. Pastaj fusni brënda këmbën tjetër dhe veproni në po të njëjtën mënyrë.

